



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:077714
Datë: 04.06.2024
Numri i dokumentit: 05841866

AA.nr.669/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B. me a dresë Rr. “...” Nr.... P., përfaqësuar nga J. Xh. dhe L. L., kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Media i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit H. Zagregja G., me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.917/2021, të datës 07.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04.06.2024 merr;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komisioni i Pavarur për Media i Republikës së Kosovës, e datës 16.08.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.917/2021, të datës 07.07.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet kërkesëpadia e paditësit, B. si e bazuar dhe Anulohet vendimi i të paditurës KPM- Bordi i Ankesave nr.ref: ... dhe ... dt. Në pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës administrative.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditurës, ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të drejtës materiale dhe gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.917/2021, të datës 07.07.2023; Vërtetohet vendimi i KPM-së/Bordit të Ankesave si organ i paditur, si i drejtë dhe bazuar në legjislacionin përkatës së KPM-së; ose vendimi të kthehet në rishqyrtim në mënyrë që gjykata e shkallës së parë të bëjë vlerësim të plotë të ligjshmërisë së vendimit të KPM-së me Kodin Etik KKPM-... .

I autorizuari i paditësit me datë 13.09.2023, ka parashtruar në gjykatë përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kontestuar të njëjtën, me propozim që ankesa në tërësi të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.917/2021, të datës 07.07.2023.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se;

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Vendimin nr.... i datës ..., ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e R. Ref..... e datës, kundër vendimit të Komisionit Ref.... të datës ..., sa i përket shkeljes së nenit 5 paragrafi 5 dhe nenit 7 paragrafi 6 të Kodit të Etikës KKPM-..., ndërsa pjesa tjetër e Vendimit mbetet në fuqi.

Kundër këtij Vendimi, paditësi inicon konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, me propozim që i njëjti të anulohet. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 07.07.2023, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e anulon vendimin e të paditurës, me arsyetim ndër të tjera se: Duke analizuar nëse vendimi i kontestuar me padi është i ligjshëm, Gjykata i referohet Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila në kuadër të neni 40 [Liria e Shprehjes] ka përcaktuar se 1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Neni 42 [Liria e Medieve] 1. Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve. 2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet mediave, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. 3. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.

Gjykata i referohet edhe neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] sipas të cilit “të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Duke analizuar vendimin e kontestuar me padi, Gjykata konsideron se nuk rezulton që organi i paditur të ketë marrë në konsideratë interpretimet dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me rastin e vendosjes së çështjes administrative lidhur me pretendimet ankimore të paditësit.

Kurse sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që gjen zbatim të drejtpërdrejtë në sistemin juridik të Rep. së Kosovës parashihet që “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj

dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Në mungesë të interpretimit të organi të paditur dhe pa ofruar arsyeje mjaft bindëse në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se interpretimi juridik i dhënë në vendimin e kontestuar me padi të jetë i ngushtë në fushëveprim. Për dallim nga përfundimi i organit të paditur, Gjykata konsideron se kualifikimet ndaj shkrimit të R. të kundërshtuara në KPM si organ i paditur nuk duket se përbëjnë fyerje ngaqë gjuha e përdorur është sarkastike.

Duke vepruar në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës që e bën të detyrueshme zbatimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është vet GJEDNJ e cila në një numër të rasteve ka konsideruar se promovimi i debatit të lirë është një tipar i rëndësishëm i një shoqërie demokratike duke konsideruar se kërkohen arsye shumë të forta për të justifikuar kufizimet e fjalës politike. Lejimi i kufizimeve të gjera të fjalës politike në raste individuale do të ndikonte pa dyshim në respektimin e lirisë së shprehjes në përgjithësi në shtetin në fjalë (shih Brasilier kundër Francës, nr. 71343/01, § 41, 11 prill 2006).

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, organi i paditur nuk ka vepruar konform kërkesave të përcaktuara me nenin 40, 42 dhe 53 të Kushtetutës së Rep. së Kosovës dhe praktikës relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me rastin shqyrtimit të ankesës së palës paditëse kundër vendimit të KPM-së nr. Ref .../KPM të datës

Kolegji i gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm konkludimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë si në aktgjykimin e ankimuar. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore në të cilat bazohet, sepse në bazë të provave të administruara gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit përfundimtar në procedurë administrative si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, konstatohet me të drejtë se i njëjti përmban të meta esenciale, dhe nuk është i plotë dhe përmbajtjesor ashtu si parashihet me dispozitat ligjore të LPPA-së, si në nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Organi i paditur është dashur, që pas shqyrtimit të ankesës së paditësit, të nxjerr aktvendim ashtu si parashihet me nenet e lartcekura të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke i shqyrtuar dhe potencuar theksimet dhe pretendimet në ankesë. Aktvendimi do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjet faktike, bazën ligjore në të cilat bazohet akti andaj për shkak të metave të tilla nuk mund të vlerësohet si vendim i drejtë dhe ligjor.

Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë, duke anuluar vendimin e të paditurës, për faktin se vendimi është nxjerr në kundërshtim të plotë me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kolegji gjen se bazuar në provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, ka vendosur drejtë dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare dhe baza ligjore në të cilën bazohet aktgjykimi për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, sepse e paditura ka vepruar në kundërshtim me Ligjin.

Edhe pse e paditura me ankesë nuk është thirr në shkelje të dispozitave procedurale, gjykata sipas detyrës zyrtare është kujdesur dhe e njëjta konstaton se nuk ka shkelje të dispozitave procedurale, sepse gjykata e shkallës së parë fillimisht ka shqyrtuar padinë e paditëses, pastaj ka dërguar

padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, dhe shkresat tjera të lëndës dhe ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës, në ankesë janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Kolegji i gjykatës së Apelit, i shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet e të paditurës në ankesë dhe konstaton se të njëjtat janë të pabazuara në prova, të pa ndikim për tu ndryshuar gjendja faktike dhe për tu vendosur çështja në mënyrë tjetër, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në procedurë gjyqësore, sepse nga të cekurat më lartë, si dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, vërtetohet se në këtë çështje juridike administrative të paditëses, organi i paditur nuk ka vepruar konform kërkesave të përcaktuara me nenin 40, 42 dhe 53 të Kushtetutës së Rep. së Kosovës dhe praktikës relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me rastin shqyrtimit të ankesës së palës paditëse kundër vendimit të KPM-së nr. RefKPM të datës Andaj thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Kolegji duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale, me rastin e aprovimit të kërkesë padisë së paditëses dhe anulimin e vendimit të paditurës dhe pasi që me thëniet në ankesë, aktgjykimi i shkallës së parë nuk vihet në dyshim, ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat më lartë, e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.669/2023, me datë 04.06.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi